

KQZ
U PROTOKOLLUA
NR. 1608 PROT
DATE 2.3.2021

Raport i Auditit teknikien për ekstraktin e v



RAPORT

MBI AUDITIMIN E EKSTRAKTIT TË V TË PËRBËRËSVE ZGJEDHORË

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4

Tiranë, Shqipëri

BRISELA MEHMETLLARI

Audit Teknikien

10/17/2001
1000
DATE

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


I nderuar z.Kryetar,

Të nderuar anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në zbatim të vendimit Nr. 13, datë 28.10.2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për emërimin e auditit teknikien për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve, për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të datës 25 Prill 2021”, si dhe duke ndjekur udhëzimin Nr.2, datë 28.12.2012 të KQZ “Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknikien për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) dhe në sistemin elektronik të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve (SEV), ju sjellim si më poshtë raportin e auditimit të kryer për periudhën 04 Janar 2021 – 31 Janar 2021.


Në këtë raport jepen vlerësimet dhe rekomandimet për veprimet e kryera mbi bazën e të dhënave në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile duke analizuar ekstraktin të V të përbërësve zgjedhore dhe listat e zgjedhësve të gjeneruara nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile(RKGJC) në zbatim të “Kodit Zgjedhor”, Ligjit “Për Gjendjen Civile” dhe akteve të mëposhtëme nënligjore:

- Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.298, datë 10.09.2020 “Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë”.
- Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme, Nr.225, datë 11.05.2016 “Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga Ligji Nr.138/2015 “Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike”.
- Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.370, date 07.12.2012 “Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile”



Përmbajtja

Hyrje.....	4
Baza ligjore e auditimit	4
Metodologjia e Auditimit	5
Opinione.....	6
Rekomandime.....	8
Statistika	9
Përfundime	12



Hyrje

Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, sipas dekretit Nr. 11700 të Presidentit të Republikës, datë 09.06.2020, do të zhvillohen më datë 25 prill 2021. Pas krijimit të përvojës nga zgjedhjet e datës 21 Qeshor 2015 për organet e qeverisjes vendore, të bazuara mbi ndarjen e re Administrativo-Territoriale të njëjste të qeverisjes vendore, këto zgjedhje pritet të jenë më të konsoliduara dhe me problematike më të ulët përsa i perket informacionit të gjeneruar nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile.

Baza ligjore e auditimit

- Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin Nr.74/2012, datë 19.07.2012 , ligjin Nr.31/2015, datë 02.04.2015 dhe ligjin 101/2020.
- Ligji Nr.10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar me ligjin Nr.6/2012, datë 02.02.2012, ligjin Nr.130/2013 datë 25.04.2013, ligjin Nr.134/2016 datë 22.12.2016 dhe ligjin Nr.69/2018 datë 11.10.2018.
- Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.
- Vendimi i KM Nr.365, datë 11.6.2004 “Për krijimin e mënyrën e mbajtjes së Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe për rregullat e shfrytëzimit të teknikës dhe rrjetit informatik”.
- Vendimi i KM Nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar me Vendimin e KM Nr.36, datë 24.01.2018, Vendimin e KM Nr.88, datë 14.02.2018 dhe Vendimin e KM Nr.448, datë 26.07.2018.
- Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.289, datë 10.09.2020 “Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë”.
- Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme, Nr.225, datë 11.05.2016 “Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë denimin e parashikuar nga Ligji Nr.138/2015 “Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike”.
- Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.370, date 07.12.2012 “Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile”.
- Udhëzimit të KQZ-së Nr.2, datë 28.12.2012 “Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditet tekniciene për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) dhe ne sistemin elektronik të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve (SEV).



Metodologjia e Auditimit

Përgjegjësia e audituesit është që të verifikojë përputhshmërinë e veprimeve të kryera nga DPGJC me rregullat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor, Ligjin për “Gjendjen Civile” dhe aktet e nxjerra në zbatim të tyre nga KQZ-ja dhe Ministri i Brendshëm, mbi bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile nga fillimi i procesit deri në shpalljen e listave përfundimtare të zgjedhësve.


Listat e zgjedhësve janë dokumente zyrtare të zgjedhësve, që burojnë nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile për çdo zonë të qendrës së votimit, të hartuara në përputhje me këtë Kodin Zgjedhor. Auditimi për përbërësit zgjedhorë në kuptimin që ka dhënë Kodi Zgjedhor në nenin 45 nënkupton auditimin për përbërësit e gjendjes civile si më poshtë:

- a) Emri
- b) Atësia
- c) Amësia
- d) Mbiemri
- e) Datëlindja
- f) Numri Personal i Identifikimit
- g) Shtetësia
- h) Kodi i Vendbanimit
- i) Gjinia

Auditimi është kryer mbi parimin e prezumimit të vërtetësisë së të dhënave të vëna në dispozicion nëpërmjet:

1. Informacioni zyrtar publik nga Ekstrakti i Pestë i Përbërësve Zgjedhorë (31.01.2021) të publikuar *online*.
2. Gjithashtu, nga punonjës të DPGJC është mundësuar aksesimi me të drejta leximi (View) në RKGJC, me qëllim realizimin e auditit.
3. Për realizimin e kërkesave të këtij auditimi janë kryer verifikime/testime të bazuara në kontrollet mbi ekstraktet përkatës si dhe RKGJC, duke filtruar fushat /rekordet përkatës në bazë të përcaktimeve ligjore në fuqi.

Verifikimi i dublimeve, gjatë fazës së parë të auditit janë vënë në dispozicion nga punonjësit e DPGJC. Sipas tyre testimi është realizuar mbi bazën e krahasimit dhe të ngjashmërisë së rubrikave të përbërësve zgjedhore sipas aneksit nr.1 të Udhëzimit të Ministrisë të Brendshëm Nr.370, date 07.12.2012 “Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile”.




Opinione

Janë zbatuar përgjithësisht procedurat në zbatim të udhëzimit të Ministrit të Brendshëm, Nr.298, datë 10.09.2020 “Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë”, të udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme, Nr.225, datë 11.05.2016 “Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga Ligji Nr.138/2015 “Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike” dhe të udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.370, date 07.12.2012 “Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile”.

- Janë gjeneruar brenda afateve ligjore në respekt të pikave 5 dhe7, të nenit 51 të Kodit Zgjedhor, dy ekstraktet e dytë të përbërësve zgjedhore, ekstrakti i tretë më datë 01.12.2020, ekstrakti i katërt më datë 04.01.2021, ekstrakti i pestë më datë 31.01.2021.
- Në zbatim të përcaktimeve të pikës ç), të nenit 48 të Kodit Zgjedhor: Është publikuar lista e zgjidhësve online:

https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=12416 , link-un e të cilës mund ta gjeni te e-albania, faqja zyrtare e KQZ, gjithashtu në faqen zyrtare të MB. Shërbimi elektronik “Kërkimi i qendrës së votimit (QV)” i mundëson çdo shtetasi shqiptar të kërkojë adresën e qendrës së votimit në të cilën është caktuar të votojë. *Të dhënat e përdoruesve shfaqen automatikisht nga databaza e Gjendjes Civile dhe Adresarit, të cilat administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Në asnjë rast e-Albania nuk modifikon të dhënat e publikuara.*

	Ekstrakti 31.01.2021
Informacioni listat e zgjedhjeve	
Numri i përgjithshëm qendrave të votimit	5,161 qv
Numri i Qendrave të votimit mbi limitin (1000 zgjedhës)	4 qv
Numri i Qendrave të votimit nën limitin (20 - 300 zgjedhes)	38 qv
Numri i Qendrave nga 1 deri ne 20 zgjedhës	31 qv
Lista e shtetasve 100 vjeç të papërfshirë nga lista	2,942
Lista e shtetasve (dekriminalizimi) të papërfshirë nga lista	989
Lista zgjedhesve me numër banimi 000/ 888/ 999	53
Numri i zgjedhësve në total të perfshirë në lista	3,582,986
Të papërfshire në lista (për shkak të qendrave jashtë limitit)	11,886
Numri total i zgjedhësve	3,594,872
Meshkuj	1,778,912
Femra	1,815,960



- Vazhdon përmirësimi mjaft i vazhdueshëm nga ekstrakti i katërt në ekstraktin e pestë në:

Numri i Qendrave të votimit nën limitin (20 - 300 zgjedhës) nga 43 qv në 38 qv;

Numri i Qendrave nga 1 deri ne 20 zgjedhës nga 58 qv në 31 qv;


Lista e shtetasve 100 vjec te pa perfshire nga lista nga 3,002 në 2,942;

Numri i zgjedhësve në total të perfshirë në lista nga 3,585,880 (3,597,890 nr total i zgjedhësve) në 3,582,986 (3,594,872 nr total i zgjedhësve);

Të papërfshire në lista (për shkak të qendrave jashtë limitit) nga 12,010 në 11,886.

- Vihet re nje rritje e nr të qendrave të votimit mbi limitin (1000 zgjedhës) nga ekstrakti i katërt në ekstraktin e pestë në:

Numri i Qendrave të votimit mbi limitin (1000 zgjedhës) nga 3 qv në 4 qv.



Rekomandime

Bazuar në auditimin e kryer për ekstraktin e V të përbërësve zgjedhore rekomandoj që:

1. Në mënyrë që mos të këtë më qendra votimi me numër zgjedhësish jashtë kriterëve ligjore sugjeroj që të kryhen ndryshime në sistemin informatik qendror të DPGJC në mënyrë që punonjësit e zyrave të gjendjes civile mos të mundën që një zgjedhësi t'í vendosin një numër QV-je e cila është:
 - Jashtë përcaktimeve ligjore
 - Nuk është aktive (pa votues)
 - Ka numer të ndryshëm nga udhëzimet në fuqi për përcaktimin e numrit të QV-së për rastet specifike (psh.8899 ose 7788)

Gjithashtu rekomandohet që po në sistem të kryhen ndryshime për të detyruar që:

- Nëse ndryshon një nga fushat “numban”, “adresa”, “komuna/bashkia”, “FamilyID” apo “zyra e gjendjes civile”, do të duhet të konfirmohet edhe numri i QV-së.
 - Nëse ndryshon fusha “bashkia” apo “zyra e gjendjes civile” të ndryshojë edhe numri QV-së duke qenë i ndryshëm nga i mëparshmi.
2. Duhet të vazhdojë dhe të intensifikohet bashkëpunimi me zyrat e Gjendjes Civile dhe njësisve të qeverisjes vendore në favor të procesit të verifikimit dhe më pas pastrimit të numrit potencial të dublimeve nga lista e rekordeve të dyshuar si të dubluar.
 3. Të vijojë puna për verifikimin dhe zbatimin e procedurës së pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit e mbetur, që vuajnë dënimin e parashikuar nga Ligji Nr.138/2015 “Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike”.
 4. Për reflektimin dhe përmirësimin e numrit të shtetasve të pezulluar nga lista e zgjedhësve për arsye të zbatimit të udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme, Nr.225, datë 11.05.2016 “Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga Ligji Nr.138/2015 “Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike”, do të duhet një bashkëpunim dhe koordinim më i mirë midis Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

5. Priten përmirësime në:

Numri i Qendrave të votimit mbi limitin (1000 zgjedhes).

Numri i Qendrave të votimit nën limitin (20 - 300 zgjedhes).

Numri i Qendrave nga 1 deri në 20 zgjedhes.


Lista e shtetasve 100 vjeç të paperfshirë nga lista.

Numri i zgjedhesve në total të paperfshirë nga lista.

Lista e shtetasve (dekriminalizimi) të paperfshirë nga lista.

Te paperfshirë nga lista (për shkak të qendrave jashtë limitit).

Dhe më e rëndësishmja: Lista e zgjedhesve me numër banimi 000 / 888 / 999.



Statistika

Në bazë të ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë të gjeneruara në datën 31 Janar 2021 kemi si më poshtë:

1. Numri i përgjithshëm i zgjedhësve në lista

Është bërë kontrolli duke gjeneruar nga RKGJC listën për të gjithë ata shtetas të cilët janë zgjedhës sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin Nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin Nr.31/2015, datë 02.04.2015.

- Në ekstraktin e datës 31 Janar 2021 rezultuan gjithsej 3,594,872 zgjedhës.

Nga të cilët:

- Në ekstraktin e datës 31 Janar 2021 rezultuan 1,778,912 zgjedhës meshkuj dhe 1,815,960 zgjedhës femra.

Nga krahasimi me ekstraktin e katërt vihet re një diferencë (ulje e numrit) prej **3018** e numrit total të zgjedhësve, e cila vjen si pasojë e reflektimit të numrit të vdekjeve gjatë periudhës midis ekstraktit të pestë dhe të katërt, nga reflektimet e prapambetura që janë në vazhdim si dhe nga verifikimi i dublimeve.


Ju bëjmë me dije se në asnjë nga ekstraktet zgjedhore të gjeneruara deri më tani nuk janë shkelur asnje nga pikat e nenit 51 të kodit zgjedhor. Në të gjitha zyrat e gjendjes civile janë printuar listat e zgjedhësve të ekstrakteve zgjedhore në përputhje me nenin 51 të kodit zgjedhor. Gjithashtu, për arsye të praktikave dhe procedurave të brendshme të ZGJC-ve, janë gjeneruar statistikat të QV-ve që janë mbi dhe nën limit si dhe më të dhënat e zgjedhësve në këto QV, me qëllim informimin e kryetarëve të bashkive, për të vijuar me nxjerrjen e vendimeve për ndarje / bashkim të qendrave të votimit.

Sqaroj se duhet të vazhdojë dhe të intensifikohet bashkëpunimi me zyrat e Gjendjes Civile dhe njësisive të qeverisjes vendore në favor të procesit të verifikimit dhe më pas pastrimit të numrit potencial të dublimeve nga lista e rekordeve të dyshuar si të dubluar.

2. Numri i qendrave të votimit (QV)

Nga kontrolli dhe verifikimi i ekstraktit të dates 31 Janar 2021 rezulton:

- Numri i përgjithshëm i qendrave të votimit me numër zgjedhësish brenda përcaktimeve ligjore është : 5,161 qendra votimi
- Numri i qendrave të votimit me numër zgjedhësish mbi 1,000 është: 4 qendra votimi. (rritur me 4 krahasuar me ekstraktin e dates 04 Janar 2021)



*Sqaroj se ky numër **duhet** të vijë në zbritje, dhe kërkon një bashkëpunim më të madh me nëpunësit e ZGJC.*

- Numri i qendrave të votimit me numër zgjedhësish 20-300 është: 38 qendra votimi.

*Sqaroj se ky numër **duhet** të vijë në zbritje, dhe kërkon një bashkëpunim më të madh me nëpunësit e ZGJC.*

- Numri i qendrave të votimit me numër zgjedhësish nën 20 është: 31 qendra votimi (rritur me 4 krahasuar me ekstraktin e datës 01 Nëntor 2020, dhe ka ardhur duke u ulur krahasuar me ekstraktin e dates 04.01.2021)

*Sqaroj se ky numër **duhet** të vijë në zbritje sepse shkaktohet si pasojë e gabimeve njerëzore të nëpunësve të ZGJC gjatë përpilimit të dokumentacionit për transferimin e shtetasve nga një zyrë e gjendjes civile në një tjetër për arsye të ndryshimit të vendbanimit.*

- Numri i zgjedhësve mbi 100 vjeç të papërfshirë në lista rezulton: 2,942 zgjedhës .

Vihet re një ulje e numrit të këtyre shtetasve me 60 zgjedhës, duke ju referuar ekstraktit të katërt të datës 04.01.2021, si pasojë e kërkesave që kanë bërë këta zgjedhës për tu përfshirë në listat e votimit dhe verifikimeve përkatëse të kryera nga Zyrat e Gjendjes Civile. Nga ana e saj DPGJC ka gjeneruar raporte mujore me të dhënat e personave mbi 100 vjeç të cilat u janë dërguar zyrave përkatëse të Gjendjes Civile me qëllim që në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore të kryhet procesi i njoftimit dhe verifikimit të këtyre personave.


*Sqaroj se Zyrat e Gjendjes Civile **duhet** të vazhdojnë me verifikimet.*

- Numri i zgjedhësve me kod vendbanimi të papërcaktuar 000,888 dhe 999 rezulton: 53 zgjedhës

Vihet re një ulje e numrit të këtyre shtetasve me 54 zgjedhës midis referuar ekstraktit të katërt. Ky përmirësim ka ardhur si pasojë e një bashkëpunimi dhe koordinimi shume të mirë midis Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Njësive të Qeverisjes Vendore.

*Sqaroj se për numrin e zgjedhësve me kod vendbanimi të papërcaktuar, pritët bashkëpunim dhe koordinim shume të mirë midis Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Njësive të Qeverisjes Vendore për të mos patur kë kategori zgjedhësish, numri i zgjedhësve për këtë kategori **duhet** të jetë 0.*

- Numri i zgjedhësve të papërfshirë në lista për shkak të qendrave jashtë limitit rezulton: 11,886 zgjedhës
(Në ekstraktin e datës 04 Janar 2021 rezultuan gjithsej 12,010 zgjedhës, sic shihet kjo shifër ka ardhur duke u ulur)



Sqarohet se Zyrat e Gjendjes Civile **duhet** të vazhdojnë me verifikime, në mënyrë që të ulen numri i zgjedhësve të paperfshire ne lista për shkak të qendrave jashte limitit.

3. Numri i zgjedhësve të perfshire nga lista nga dekriminalizimi

Në këtë kategori bëjnë pjesë ata zgjedhës të cilët janë pezulluar nga lista e zgjedhësve për arsye të zbatimit të udhëzimit të Ministrisë të Punëve të Brendshme, Nr.225, datë 11.05.2016 “Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga Ligji Nr.138/2015 “Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike”. Nga kontrolli dhe verifikimi rezultoi se janë: 989 zgjedhës (nga 1,111 zgjedhës duke ju referuar Ekstraktit të datës 04.01.2021)

Për reflektimin dhe përmirësimin e numrit të këtyre shtetasve do të duhet të vijohet me një bashkëpunim dhe koordinim më të mirë midis Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.



Përfundime

Auditimi për përbërësit zgjedhorë në kuptimin që ka dhënë Kodi Zgjedhor në nenin 45 nënkupton auditimin për përbërësit e gjendjes civile si më poshtë:

- a) Emri
- b) Atësia
- c) Amësia
- d) Mbiemri
- e) Datëlindja
- f) Numri Personal i Identifikimit
- g) Shtetësia
- h) Kodi i Vendbanimit
- i) Gjinia

➤ Në ekstraktin e datës 31 Janar 2021 rezultuan gjithsej 3,594,872 zgjedhës.

Nga të cilët 1,778,912 zgjedhës meshkuj dhe 1,815,960 zgjedhës femra.

Nga krahasimi me ekstraktin e katërt vihet re një diferencë (ulje e numrit) prej **3018** e numrit total të zgjedhësve, e cila vjen si pasojë e reflektimit të numrit të vdekjeve gjatë periudhës midis pesë ekstrakteve, nga reflektimet e prapambetura që janë në vazhdim si dhe nga verifikimi i dublimeve.


Duhet të vazhdojë dhe të intensifikohet bashkëpunimi me zyrat e Gjendjes Civile dhe njësisve të qeverisjes vendore në favor të procesit të verifikimit dhe më pas pastrimit të numrit potencial të dublimeve nga lista e rekordeve të dyshuar si të dubluar.

Numri i qendrave të votimit me numër zgjedhësish mbi 1,000 **duhet** të vijë në zbritje, dhe kërkon një bashkëpunim më të madh me nëpunësit e ZGJC.

Numri i qendrave të votimit me numër zgjedhësish 20-300 - **duhet** të vijë në zbritje, dhe kërkon një bashkëpunim më të madh me nëpunësit e ZGJC.

Numri i qendrave të votimit me numër zgjedhësish nën 20 **duhet** të vijë në zbritje. Duhet të eliminohen gabimet njerëzore të nëpunësve të ZGJC gjatë përpilimit të dokumentacionit për transferimin e shtetasve nga një zyrë e gjendjes civile në një tjetër, për arsye të ndryshimit të vendbanimit.

Numri i zgjedhësve mbi 100 vjeç të papërfshirë në lista- **duhet** të vijë në zbritje, Zyrat e Gjendjes Civile **duhet** të vazhdojnë me verifikimet.



Numri i zgjedhësve me kod vendbanimi të papërcaktuar 000,888 dhe 999 - **duhet** bashkëpunim dhe koordinim shumë të mirë midis Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Njësive të Qeverisjes Vendore për të mos patur këtë kategori zgjedhësish.

Numri i zgjedhësve të paperfshire ne lista për shkak të qendrave jashte limitit, **duhet** të vazhdojnë Zyrat e Gjendjes Civile me verifikime, në mënyrë që të ulet munri i zgjedhësve të paperfshire ne lista për shkak të qendrave jashte limitit

Numri i qendrave të votimit me numër zgjedhësish nën 20, ky numër **duhet** të vijë në zbritje sepse shkaktohet si pasojë e gabimeve njerëzore të nëpunësve të ZGJC gjatë përpilimit të dokumentacionit për transferimin e shtetasve nga një zyrë e gjendjes civile në një tjetër për arsye të ndryshimit të vendbanimit

Në asnjë nga ekstraktet zgjedhore të gjeneruara deri më tani nuk janë shkelur asnje nga pikat e nenit 51 të kodit zgjedhor. Në të gjitha zyrat e gjendjes civile janë printuar listat e zgjedhësve të ekstrakteve zgjedhore në perputhje me nenin 51 të kodit zgjedhor.

Janë zbatuar përgjithësisht procedurat në zbatim të udhëzimit të Ministrit të Brendshëm, Nr.298, datë 10.09.2020 “Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë”, të udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme, Nr.225, datë 11.05.2016 “Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga Ligji Nr.138/2015 “Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike” dhe të udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.370, date 07.12.2012 “Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile.

1. 1991
2. 1992
3. 1993
4. 1994
5. 1995

6. 1996
7. 1997
8. 1998

9. 1999
10. 2000
11. 2001
12. 2002
13. 2003
14. 2004
15. 2005